



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: 08.01.2025		
Priljeno: 08.01.2025		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-052/01-1045		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Datë:	08.01.2025
Referencë:	
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi – Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	Komisioni për hartimin e Rregullores në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit.
Lënda:	Raport nga procesi i konsultimit publik i draft- Draft Planin i Rregullores për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale të Lipjanit

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit Komisioni për hartimin e Rregullores Draft Rregullore për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale të Lipjanit dhe Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Draft Rregullore për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale të Lipjanit

Ku është publikuar edhe njoftimi me bashkëlidhjen e konsultimeve publike ku ka qenë në diskutim publik ky dokument si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetet sociale të komunës si dhe në platformen e konsultimeve publike të Qeverisë së Kosovës.

Shih linqet:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/?page=2024>

<https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/15-26-21-03122024/Vendim-per-konsultimin-e-publikut-Projekt-Rregullorja-per-organizimin-e-brendshem--shqip.pdf>

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42712>

Ecuria e Procesit

Komisioni për hartimin e Rregullores në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna. Në bashkëpunim me kordinatorin për konsultime publike kanë publikur në web faqen e komunës njoftimin me datë 04.12.2024 për mbajtjen e konsultimit-debatit publik Rregulloren për Klasifikimin e Rregullores për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale të Lipjanit

në linkun:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2024/12/Njoftim-pEr-debat-publik-Projekt-Rregullorja-organizim-sistematizim-dhe-klasifikimin-e-vendeve-te-punes.pdf>

Ndërsa takimi konsultativ-debati është realizuar në kohën e paraparë dhe me dt. 12.12.2024 është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit duke filluar nga ora 10:15

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/?newsct=u-organizua-debat-publik-per-draft-rregulloren-per-organizimin-e-brendshem-sistematizimin-dhe-klasifikimin-e-vendeve-te-punes-ne-komunen-e-lipjanit>

Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore z. Xhevahire Zeqiri, ka hapur takimin dhe prezantoi para të pranishmëve hartimin e draft Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Lipjanit ku ka cekur se në hartimin e Rregullores kanë marrë pjesë edhe anëtarët e komisionit. Në këtë draft Rregullore janë parapare drejtoratet, sektorët dhe tituj e pozitive të punës në Administratën Komunale të Lipjanit duke cekur në pika të shkurtra edhe përshkrimin e detyrave të punës për secilin drejtorat.

Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, znj. Zeqiri para të pranishmëve ka prezantuar komisionin në këtë përbërje:

1. Xhevahire Zeqiri, Udhëheqëse e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore,
2. Shehdiye Ibrahim Udhëheqëse e Sektorit për Buxhet,
3. Vlora Krasniqi, Shefe e Sektorit për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, anëtare,
4. Albert Mustafa, Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
5. Rizvan Hoxha, Zyrtar i Lartë Personelit, anëtar.

Duke i falënderuar anëtarët për kontributin e tyre në hartimin e kësaj Rregullore znj. Zeqiri ka vazhduar prezantimin duke përmendur edhe se Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i strukturës, organizimit, fushëveprimi, hierarkia e raportimit dhe klasifikimi i pozitave të punës në Komunën e Lipjanit, kjo rregullore zbatohet për të gjithë Zyrtarët Publik në Komunën e Lipjanit duke u bazuar në Ligjin për Zyrtarët Publik Nr.08/L-197 dhe Rregulloren nr. 10/2020 për Deklarimin e Statusin e Zyrtarëve Publik.



Konsultimi publik u zhvillua në prezencën e një numër të konsideruar të pjesëmarrësve, me ç'rast përfaqësues të komisionit kanë potencuar se ky takim është organizuar me qëllim që t'i ofroj publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimarrëse.

Nga ana tjetër të pranishmit paten rastin të inkuadrohen në debat dhe të japin kontributin e tyre për këtë draft rregullore që të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe në përputhje me normat më të larta ligjvënëse.

Komentet nga debati konsultativ lidhur me Draft Rregulloren për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale të Lipjanit

Temat e Konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetjet / komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin të komenteve është i detyrueshëm)

Draft Rregullore për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale të Lipjanit	Ka pyetur se a janë marrë parasysh edhe Ligjet e tjera në hartimin e kësaj Rregullore siq janë Ligji i shërbimeve Sociale dhe i Mirëqenies sociale?	Lorik Bërbatovci	Komisioni për hartimin e kësaj rregullore tha se jemi bazuar në Ligjin për Zyrtarët Publik Nr.08/L-197 dhe Rregulloren nr. 10/2020 për Deklarimin e Statusin e Zyrtarëve Publik.	Komenti u pranua plotësisht
Draft Rregullore për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale të Lipjanit	Zyrtarë të shërbimeve sociale a ka që janë rekrutuar me shkollë të mesme?	Lorik Bërbatovci	Komisioni ka potencuar se nuk është rekrutuar as një zyrtar me shkollë të mesme sepse nuk e lejon Ligji.	Komenti u pranua plotësisht
Draft Rregullore për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale të Lipjanit	Aktemrimin e kaluar e kam pozitën Udhëheqës i Sektorit, ndersa me Aktemrimin e ri me keni parapare si Zyrtar i lartë?	Lorik Bërbatovci	Udhëheqja e Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore theksoi se Ligji për Pagat ka paraparë në QPS vetëm një pozitë të nivelit drejues. Burimet njerëzore kanë kërkuar disa here në DMZP për realizimin e një kërkesë të tillë por nuk është realizuar, ne do e përsërisim kërkesen prap.	Komenti u pranua plotësisht

Gjatë fazës së diskutimit publik për rregulloren Draft Rregullore për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale të Lipjanit, Komisioni për hartimin e saj ka shqyrtuar me kujdes të gjitha rekomandimet e pranura nga palët e interesuara

Takimi mbaroi në ora 11:20

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuuesve
15-30 ditë pranohen komentet		16
15-30 ditë		

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë **16** pjesëmarrës, prej tyre femra **10** dhe 6 meshkuj.

Bukurie Zejnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 12.12.2024

Vendi: Salla e Kuvendit

Lista e pjesëmarrësve: Rregullorja për organizimin e brendshëm, sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në Komunën e Lipjanit

Nr.	Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
1	Merta	Bytyqi	
2	Adelina	Rehmani	
3	Shanadje	Ibrohimi	
4	Vulete	Huji	
5	Qëndresa	Jashanica Dervisku	
6	Djellza	Mukulami	
7	LAURATA	FAZLIJA	
8	Shefqet	Kozhani	
9	Lumir	Lejla	
10	Ramadan	Nuradin	
11	Fjolla	Ibrahim Starabaja	
12	Lejla	Bartorci	
13	Armend	Kozhani	
14	Bekim D.	Olluri	
15	Laurata Ahmeti	Ahmeti	
16			
17			
18			
19			
20			